



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
GRAMSH

Nr. 92 / 12 .Prot

Gramsh më 01.01.2022

**VENDIM**  
Nr. 130, datë 29.12.2021

**PËR**

**“ Miratimin e dokumentacionit tekniko – ligjor për objektin “Rikontruksion i Urës këmbësore të fshatit Liras, Njësia Administrative Pishaj”, bashkia Gramsh, si dhe akordimin e fondit të menjëhershëm nga fondi i programit të “ emergjencave civile”, palnifikuar në buxhetin e vitit 2021, me destinacion marrjen e masave parandaluese dhe rivendosjen e urës në funksion, si pasojë e situatës emergjente të krijuar gjatë muajit Dhjetor 2021.**

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës 29.12.2021, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, sektori i Emergjencave Civile dhe “ Miratimin e projektit “Rikontruksion i Urës këmbësore të fshatit Liras, Njësia Administrative Pishaj”, bashkia Gramsh, si dhe akordimin e fondit të menjëhershëm nga fondi i programit të “ emergjencave civile”, palnifikuar në buxhetin e vitit 2021, me destinacion marrjen e masave parandalues dhe rivendosjen e urës në funksion, si pasojë e situatës emergjente të krijuar gjatë muajit Dhjetor 2021”, bazuar në:

- Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligjin 45/2019 “Për mbrojtjen civile”;
- VKM nr.329 datë 16.5.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

**VENDOSI:**


1. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor ( projektit ) të hartuar nga specialistët e Bashkisë Gramsh, për rikontruksionin e Urës së fshatit Liras, Njësia Administrative Pishaj, bashkia Gramsh.
2. Të miratojë vlerën e projektit sipas preventivit përfundimtar të hartuar nga specialistët e bashkisë Gramsh dhe miratuar nga kryetari i bashkisë, për objektin “Rikontruksion i Urës këmbësore të fshatit Liras, Njësia Administrative Pishaj, bashkia Gramsh”, në vlerën 3 500 000 ( tre milion e pesëqind mijë ) lekë.

3. Ky fond do të përdoret për të rindërtuar strukturën mbajtëse për pjesën kaluese të urës, si dhe rindërtohet argjinatura prej zhavorri, pas shpatullës prej betoni në anën e fshatit Liras.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike ( Sektori i Emergjencave Civile ), si dhe Drejtoria e të Ardhurave, Zhvillimit Ekonomik dhe Menaxhimit Financar.

Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga Prefekti i Qarkut Elbasan.


**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**XHULIA GJINI**



**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**GRETA LENA**



Konceptoi: Xh. Gjini  
Pranoi: G. Lena  
Dosja nr: \_\_\_\_\_  
Afati i ruajtjes: \_\_\_\_\_

